VENDIM
Nr. 911, datë 22.12.2014

PËR PJESËMARRJEN E FORCAVE TË ARMATOSURA TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË NË OPERACIONIN "RSM", NË SHTABE TË NDRYSHME TË NATO-S, NË AFGANISTAN

(Ndryshuar me VKM nr.343, datë 12.6.2018, nr. 821, datë 18.12.2019)

(I përditësuar)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 7, të ligjit nr. 9363, datë 24.3.2005, "Për mënyrën dhe procedurat e vendosjes dhe kalimit të forcave ushtarake të huaja në territorin e Republikës së Shqipërisë, si dhe për dërgimin e forcave ushtarake shqiptare jashtë vendit", të ndryshuar, dhe të shkronjës "ç", të nenit 11, të ligjit nr. 64/2014, "Për pushtetet dhe autoritetet e drejtimit e të komandimit të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë", me propozimin e ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Dërgimin me mision të personelit të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, të përbërë nga 12 (dymbëdhjetë) ushtarakë, në shtabe të ndryshme të NATO-s, në Kabul dhe Herat, Afganistan, si më poshtë vijon:

Në Shtabin e Resolute Support Mission (RSM HQ), në operacionin RSM", në Kabul, Afganistan:

- numri i pjesëmarrjes: 1 (një) ushtarak;

- venddislokimi, Kabul, Afganistan.

Në Shtabin e Trajnim-Këshillimit dhe Ndihmës (TAAC-Capital), në operacionin "RSM", Kabul, Afganistan:

- numri i pjesëmarrjes: 4 (katër) ushtarakë;

- venddislokimi, Kabul, Afganistan.

Në Shtabin e Operacioneve të Forcave Speciale të NATO-s (NSOCC-A), në operacionin "RSM", në Kabul, Afganistan:

- numri i pjesëmarrjes: 1 (një) ushtarak;

- venddislokimi, Kabul, Afganistan.

Në Shtabin e Trajnim-Këshillimit dhe Ndihmës në (TAAC-West), në operacionin "RSM", në Herat, Afganistan:

- numri i pjesëmarrjes: 6 (gjashtë) ushtarakë;

- venddislokimi, Herat, Afganistan.

2. Misioni i personelit, që do të marrë pjesë në shtabet e sipërpërmendura, është mbështetja dhe dhënia e kontributit në funksione të ndryshme në shtabet e trajnimit, këshillimit dhe dhënies së ndihmës, në operacionin e NATO-s "RSM", Afganistan.

3. Kohëzgjatja e këtij misioni është deri më 31 dhjetor 2024. Periudha e qëndrimit në mision, për çdo kontingjent, do të jetë me sistem rotacioni çdo 6 (gjashtë) muaj, periudhë së cilës i shtohen edhe ditët e qëndrimit për ndërrimin me kontingjentin e radhës (marrjen dhe dorëzimin e detyrës, vonesa të transportit strategjik). Për postet Crisis Establishment (CE), që plotësohen nga oficerë me gradën "Kolonel", rotacioni të jetë 1 (një) vit.

4. Ministria e Mbrojtjes, për ushtarakët pjesëmarrës në këtë operacion, të përballojë shpenzimet për:

a) dieta për ditët e qëndrimit, në masën 12 000 (dymbëdhjetë mijë) lekë në ditë, përveç pagës mujore;

b)sigurimin e jetës;

c) siguracion shëndetësor jashtë zonës së operacionit;

ç) mbështetje shëndetësore;

d) shpenzime për telefon, internet dhe shërbime postare;

dh) transport;

e) transportimin e individëve të shkëputur nga misioni për në atdhe në rast vdekjeje, sëmundjeje ose thyerjeje disipline;

ë) aktivitete social - kulturore në rastet e festave kombëtare, gjatë kohës së kryerjes së misionit;

f) çdo shpenzim tjetër për mbarëvajtjen e kryerjes së operacionit.

5. Transporti i personelit që do të shërbejë në Afganistan, ndërsa nis, ndryshon dhe përfundon detyrën për t'u kthyer në Shqipëri, mbështetja shëndetësore, akomodimi, ushqimi, lavanteria të përballohet nga buxheti i Ministrisë së Mbrojtjes, me përjashtim të rasteve kur do të arrihet nënshkrimi i marrëveshjeve dy - ose shumëpalëshe ku pala tjetër merr përsipër të përballojë këto shpenzime.

6. Ministria e Mbrojtjes të bëjë sigurimin e jetës nga aksidentet për ushtarakët e Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, të cilët do të marrin pjesë në këtë mision.

7. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga fondet e miratuara në buxhetin e Ministrisë së Mbrojtjes.

8. Ngarkohet ministri i Mbrojtjes për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINSTRI
Edi Rama